



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 312 / Prot
7

Datë 30 / 06 / 2025

V E N D I M

Nr. 4

Datë 27 / 06 / 2025

P Ë R

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT BERAT TË VITIT 2025, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT TË QARKUT NR.02, DATË 08.04.2025

Këshilli i Qarkut Berat pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e Projekt Buxhetit të ndryshuar të Këshillit të Qarkut Berat për vitin 2025, mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë :

- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40, i ndryshuar
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 8, pika 2 ,neni 9 pika 1.1, b, neni 31 pika 1,2,3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligji Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 10/1 i vitit 2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
- Ligji Nr. 115/2024, “Për Buxhetin e vitit 2025”
- Udhëzimi plotësues nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”
- Ligje dhe akte nën ligjore të tjera,

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Qarkut nr.2, datë 08.04.2025 të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

A. Shtohen të ardhurat në shumën totale 52,686,497.68 lekë nga të cilat:

a) Të ardhura nga Bashkia Polican	20,000,000	lekë
b) Të ardhura nga rimbursimi i projektit	24,086,497.68	lekë
c) Të ardhura nga parafinancimi kap 02	8,600,000	lekë

B. Shpenzimet gjithsej shtohen në shumën 52,686,497.68 lekë

Shpenzimet kapitale shtohen në shumën 47,586,497.68 lekë

Nga të cilat:

- Projekti "Rehabilitim i rrugës nga Lapidari deri në Kakrrukë" 9,395,303 lekë
- Projekti "Asfaltim i rrugës Terpan-Teman, NjA Terpan" 20,000,000 lekë
- Projekti "Digital Tools" 9,471,194.68 lekë
- Parafinancim në kapitullin 02 për Projektin Digital Tools 8,600,000 lekë
- Shpenzime për rritjen e AQT 120,000 lekë

Shpenzimet operative shtohen në shumën 5,100,000 lekë

Në zërin:

- Shpenzime për vendime Gjyqësore 5,100,000 lekë

2. Të miratojë ndryshimet si më poshtë:

Shtesa:

(Shifrat janë në lekë)

Programi	Kapitulli	Përshkrimi	Artikulli	Shuma
04520	05	Projekti "Rehabilitim i rrugës nga Lapidari deri në Kakrrukë"	231	2,500,000
04910	05	Fond rezerve	602	344,655
		Shuma e shtesave		

Pakësime:

(Shifrat janë në lekë)

Programi	Kapitulli	Përshkrimi	Artikulli	Shuma
05100	05	Projekt me BE Digital Tools	231	2,844,655
		Shuma e pakësimeve		2,844,655

2. Shpenzimet do të përdoren sipas pasqyrave pjesë e këtij vendimi.

3. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut.

4. Përgjegjësi i Sektorit të Financës autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për çdo muaj.

Këshilltarë gjithsej 18
Morën pjesë 12
Votuan Pro 12
Votuan Kundër —
Abstenim —

KRYETAR
Donald MOLISHTI

Burimi i financimit (Kapitulli)	Shtohen të ardhurat	52,686,497.68
05	Rimbursimi i shpenzimeve të projektit Easte Rreact	24,086,497.68
05	Të ardhura nga Bashkia Poliçan	20,000,000.00
02	Parafinancimi i projektit Digital Tools	8,600,000.00
Struktura	Shtohen Shpenzimet	52,686,497.68
05/04520 /231	Projekti “Asfaltim i rrugës Terpan-Teman, NjA Terpan”	20,000,000.00
05/05100/231	Parafinancimi i projektit Digital Tools	8,600,000.00
05/01110/602	Shpenzime operative për Vendime Gjyqësore	5,100,000.00
05/01110/231	Shpenzime për rritjen e AQT (Blerje Kondicioner)	120,000.00
05/04520/231	Projekti “Rehabilitim i rrugës nga Lapidari deri në Kakrrukë” (Qarku)	9,395,303.00
05/05100/231	Projekti Digital Tools	9,471,194.68
Per shpenzime kapitale		47,586,497.68
Per shpenzime operative		5,100,000.00

Struktura	Ndryshimet	
05/05100/231	Pakësohet Projekti Digital Tools 231	2,844,655
05/04520/231	Shtohet Projekti “Rehabilitim i rrugës nga Lapidari deri në Kakrrukë”(B.SK)	2,500,000
05/04910/602	Shtohet Fondi Rezerve 602	344,655